



Nr. 14 prot
Dt. 31/05/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 9, datë 20/05/2022

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES “KËRKES
PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”,
SHOQËRISË “GJOKA 2002” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime industriale Leje me Nr.90/38, datë 23.02.2017 miratuar nga KBU Drin-Bunë me Vendim Nr.43, datë 13.02.2017, subjektit “Gjoka 2002” sh.p.k., me vendndodhje, Shëngjin, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH),

- X=469061.6
- Y=4627308.1
- Z=3 m.m.n.d

Sasia e ujit që do të përdoret $Q=1.5$ l/sek
Prurja mesatare vjetore $Q=6.3$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

